

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË
"TEA-CO" SHPK FIER**

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

TË PËRGJITHËSHME DHE POLITIKAT KONTABEL

Shoqëria "Tea-Co" shpk, u regjistrua si biznes në datë 01/07/1996 me administrator Z. Anesti Rista, me objekt veprimtarie: Prodhime materiale inerte ndertimi, parafabrikate, veprimtari inventuse ndertimi, ndertime civile, industriale, punime shtres rruge, tregeti në formë të ndryshme mallra me shumicë e pakicë, agjensi transporti mallrash dhe udhëtarësh, veprimtari komisionerie, import-eksport të mallrave të ndryshme, kanalizime të cdo lloji, ujesjellsa, punime turistike. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT: J62903531F.

MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare"

Kontabiliteti i shoqërisë "Tea-Co" shpk, është organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit, si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm regjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit, respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël, ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2019 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërisë dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rumbullakime.

VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njëjtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë besueshëm nga përdoruesit.


Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me përgjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

**AKTIVI
AKTIVET MONETARE**

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare në vlerën **111,714,713 lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumentave, për sa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën **(3,350,417) lekë**, e



1



pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre nëaktiv të bilancit.

Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2018	116,040,325 lekë
Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2019	111,714,713 lekë
Diferenca	<u>(4,325,612) lekë</u>

AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 276,840,040 lekë ku përfshihen detyrimet e klientëve, llogaria 411 "Llogari e arkëtueshme" në vlerë 276,840,040 lekë dhe **kërkesa të tjera të arkëtueshme në vlerën 5,969,722 lekë** ku përfshihen: , llogaria 4671 "Jaupaj shpk" 2,000,000 leke, llogaria 467 "Debitore të tjere" 222,975.13 leke, llogaritë 444 "Tatimi mbi fitimin" 3,745,316 leke dhe llogaria 4461 "Det. Per takse dog. etvsh ne dogane" 1,430.78 leke.

INVENTARI

Inventari për vlerën 23,108,245 lekë, përfshihet llogaria ku përfshihet llogaria 327 "Inventar i imet" 31,250 leke, llogaria 331 "Prodhim ne proces" 10,436,448 leke , llogaria 3511 "Materiale dhe pjese" 11,088,473 leke, llogaria 3512 "Mallra magazina funeral" 501,318 leke dhe llog 351 "Mallra grupi I" 1,050,755.64 leke.

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktive të tjera afatgjata materiale me vlerë kontabël për vlerën 188,890,250 leke.
Të detajuara aktivet janë të pasqyruara në tabelën e amortizimit bashkangjitur bilancit.

PASIVI

HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2019 detyrimet në total janë në vlerën **294,254,936 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

Detyrimet afatshkurtra me vlerë totale 294,254,936 lekë, ku përfshihen:



Titujt e huamarrjes, "Overdraft", ne vleren 25,646,567.95 leke

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, llogaria 401 "Llogari të pagueshme" në vlerën 221,954,132 lekë.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 7,852,581 lekë, ku përfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 4,436,436.45 leke dhe llogaria 431 "Sigurime shoqerore dhe shendetesore" 3,416,145 leke.

Të pagueshme për detyrimet tatimore në vlerën 3,111,659 lekë, ku përfshihet llogaria 442 "Tatim mbi te ardhurat e personale" 1,640,429 leke, llogaria 4457 "Shteti-TVSH e pagueshme" 1,021,229.62 leke, llogaria 448 "Tatime te shtyra" 450,000 leke.

Detyrime të tjera afatshkurtëra në vlerën 35,689,996 lekë, ku përfshihet llogaria 455 "Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionerëve" ne vleren 6,036,724.45 leke dhe llogaria 457 "Dividente per tu paguar" ne vleren 29,653,272 leke.



2



KAPITALI

Gjendja e llogarive të Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vlerën **315,815,181 leke**, Kapitali në shkruar **308,744,417 leke**, Rezerva ligjore **660,000 leke**, Fitim / Humbja e vitit 2019 në vlerën **6,410,764 leke**.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2019 Shoqëria "Tea-Co" shpk ka realizuar shpenzime në masë **425,840,138 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

Mallra lendet e para dhe shërbime 244,242 lekë nga llogaria 605 "blerje/shpenzime mallra, shërbimesh" dhe llogaria 6035 "Ndrysh.gjend.mallra".

Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 313,918,723 lekë ku përfshihen: llogaria 604 "Bl.energji, avull, uje", llogaria 611 "Trajtime të përgjithshme", llogaria 6111 "Shpenzime karburanti", llogaria 613 "Qira", llogaria 616 "Sigurime", llogaria 618 "Të tjera", llogaria 625 "Transferime, udhëtim, diëta", llogaria 626 "Shpenzime postare e telekom", llogaria 6271 "Transporte për blerje", llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore", llogaria 638 "Tatime të tjera", llogaria 652 "Vlera kontab. E AQ të shitura", dhe llogaria 658 "shpenzime të tjera", llogaria 657 "Gjoha dhe demshperblime".

Paga në vlerën 95,334,410 lekë ku përfshihet 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit"

Shpenzimet e sigurimeve shoqërore për 13,069,421 lekë ku përfshihet llogaria 644 "Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore".

Amortizimi dhe shpenzime për tu shpërnadarë për 1,395,709 lekë ku përfshihet llogaria 6811 "Amortizim i AQ afatgjatë".

Shpenzimet financiare 1,498,530 lekë ku përfshihen: llogaria 628 "Shërbime bankare" leke, 667 "Shpenzime për interesa", llogaria 668 "Shpenzime financiare të tjera", llogaria 669 "Humbje nga kembimet valutore" leke .

Shpenzimet e tatimit fitimit, llogaria 694, për shumën 1,170,769 lekë.

MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **432,250,902 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku përfshihet **Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit 432,250,902 lekë** ku përfshihen llogaria 701 "Shitje e produkteve të gatshëm", llogaria 704 "Shitje e punimeve dhe e shërbimeve", llogaria 705 "Shitje mallrash". **Te ardhura nga kembimet valutore** ku përfshihet llogaria 769 "Fitim nga kembimet valutore" në vlerën 31,321.75 leke. **Te ardhura të tjera nga shfrytëzimi** në vlerën **791,666.67 leke** nga llogaria 752 "Te ardh. nga shitja AQ".

PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT

FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT	7,581,533
SHPENZIME TE PANJOHURA	223,589
TATIM FITIMI (15%).	1,170,769
FITIM/(HUMBJA) TATIMORE	6,410,764.27



3



PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në përfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim	116,040,325 lekë
Mjete monetare në fund	111,714,713 lekë
Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare	(4,325,612) lekë

Pra, ka përputhje të plote të pasqyrës të fluksit monetar dhe gjendjes të aktiveve monetare të vendosura në aktiv të bilancit.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej 315,815,181 lekë e cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2019.

SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime, nuk ka.

Duke patur parasysh shënime të mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2019.

Tiranë , më 29.03.2020



Asambleja e ortakeve

Antigoni Cobo

Anesti Rista

